



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-0222986/17 dt. 05.09.2017, në emër të pronarit Rahman Haradini nga Fushë Kosova, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kriteret e caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor dhe kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa individuale banimore/shtëpi banimore: Tipi “Vila 1”, Tipi “Vila 2”, Tipi “Vila 3”, Tipi “Vila 4”, Tipi “Vila 5” dhe Tipi “Vila 6”, me etazhitet B+P+1, në kuadër të PZHK-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 578-2, 603-3, 603-2, 603-6, 603-5, ZK Zllatar. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 20.09. deri më 04.10.2019, në e-mail adresën: urbanizimprishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Kompleks i ndërtesave individuale banimor/17 shtëpi banimore/Tipi “Vila 1”, Tipi “Vila 2”, Tipi “Vila 3”, Tipi “Vila 4”, Tipi “Vila 5” dhe Tipi “Vila 6”, me etazhitet B+P+1.
b. Vija rregulluese	Në kufi të rrugëve të planifikuara në kuadër të kompleksit
c. Vija ndërtimore	3.00÷5.00 m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	6.00 m` / 3.00÷5.00 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	6.00 m` / 3.00 m`÷6.00 m` 6.00 m` / 3.00 m`÷6.00 m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	30% e lejuar sipas PZHK-s
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	E lejuar P+1
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% e Lejuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60 % E lejuar
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	Minimum 1-VP për një njësi banimi
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro: Do të definohet pas pajisjes me pëlqim mjedisor nga MMPH	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

